



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 39
Prishtinë, më 24 maj, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mergim Lushtaku, Avdullah Hoti, Albert Kinolli, Ali Lajçi dhe Valon Ramadani.

Munguan: Emilija Rexhepi, Andin Hoti, Verica Ceraniç dhe Faton Topalli.

Stafi mbështetës: Antigona Ibraj, Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Aurel Haxhiu.

Pjesëmarrësit tjerë: Enis Halimi KQZ, Valmira Selmani KQZ, Ymer Shatri nga Audit & Conto, Besa Berisha nga Audit & Conto, Sabahate Hasanaj nga Audit & Conto, Violeta Smajlaj nga ZKA, Safet Berisha nga ZKA, Dardane Neziri nga Koha Ditore, Albulena Bytyçi nga Radio Kosova, Nora Kelmendi nga Ekonomia Online, Arbisa Shefkiu nga kallxo.com, Agnesa Haxhiu nga KDI dhe Gentianë Krasniqi nga KDI.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur 29.03.2019;
3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për raportet financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitin 2017;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua nga deputetët e pranishëm.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.03.2019

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 29.03.2019, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të Auditimit për raportet financiare dhe atyre të deklarimit financiar të subjekteve politike për vitin 2017

Kryetari përshëndeti të pranishmit dhe tregoi se të ftuar në komision janë edhe stafi i kompanisë e cila ka audituar raportet financiare të subjekteve politike për vitin 2017 dhe i dha fjalën z. Ymer Shatrit, përfaqësues i kompanisë audituese.

Ymer Shatri përshëndeti të pranishmit dhe fillimisht tha se çdo auditim kryhet nën presione të ndryshme, për shembull kompania zgjidhet 2-3 viteve mbas fushatave zgjedhore dhe është shumë e vështirë të gjenden të dhëna nga shpenzimet e partive politike dhe ato mund t' i fshehin financat dhe është problem gjetja e financimit pas 2-3 viteve. Shatri tha se në legjislacion dhe në shtetet e tjera auditori i fushatës është prezent kur mbahet tubimi, në të gjitha qytetet ku mbahen tubimet elektorale dhe auditori përcjell shpenzimet dhe merr informatat. Ai tha se problem tjetër është se a kanë pasur ato subjekt kontrata në 3 vitet e fundit, a mund të kthehet ajo përkrahje në tenderë, Audit Conto nuk kanë kompetenca të shkojnë në komune dhe të kërkojnë nga komuna kontratat e nënshkruara dhe të shohin se kush ka marrë kontrata tek ai institucion, kontratat bëhen publike në KRPP. Z. Shatri shtoi se auditorëve dhe komunave duhet t' ju jepet një urdhëresë që informata duhet t' i prezantohet auditorëve të fushatave politike dhe se është e pamundur të gjejnë informatat për këtë lloj konflikt interesi. Gjithashtu, problem tjetër tha se është mungesa e udhëheqjes së kontabilitetit, ku përpos dy partive politike në Kosovë nuk kanë kontabilist dhe se kjo ekziston në çdo raport. Z. Shatri vazhdoi duke thënë se ka qenë shumë problem edhe verifikimi i informatave ku partitë politike, përjashtuar një parti politike, nuk kanë asnjë kontabilist të certifikuar, stafi joprofesional për të udhëhequr financat e partive politike ka qenë problem tjetër. Mos publikimi i raporteve financiare në ueb faqet e tyre, përpos 3-5 partive politike. Gjithashtu, asnjë parti politike nuk ka kryer një kërkesë politike që është auditimi i brendshëm. Konfirmimet nga media, konfirmimet nga banka, partitë e vogla nuk kanë dërguar konfirmimet në banka, gjithashtu e njëjta edhe te mediat. Z. Shatri vazhdoi duke thënë se partitë politike nuk po i publikojnë financat në fushatat zgjedhore, ku mund të vërehen 20 faqe të listuara me donator të njëra parti, kurse te tjetra parti gjysmë faqe me donator e ato parti janë të përafërta me deputetë, me aktivitete që kanë zhvilluar kështu që nuk janë të gjitha informatat transparente. Shatri tha se kjo mund të jetë lehtë marrëveshje politike që mos të publikohen emrat e bizneseve të cilat përkrahin partitë politike, për arsye se mund të mos marrin tender sepse është konflikt interesi. KQZ në mungesë të stafit, financave dhe përkrahjes nuk mund të verifikojnë se a e ka dorëzuar komplet raportin, a e ka plotësuar mirë dhe se a e ka dokumentacionin mbështetës. Shatri tha se askush deri sot nuk ka marr masa për raportim të keq, për mosplotësim mirë të formularëve ose për vërejtjet që ka bërë auditori, deri më sot nuk është dënuar asnjë parti, nuk është marrë asnjë masë dhe se kjo mund të ndikojë lehtë që partitë politike mos të raportojnë si duhet. Kjo bënë auditimin të duket vetëm si obligim ligjor. Këtë vit tha se janë audituar gjithsej 19 subjekte politike, me 51 raporte, prej tyre opinion të pakualifikuar 2 nga 19, 10 raporte opinion të kualifikuar, 7 raporte mohim të opinionit. Në fushatën nacionale 2 raporte kanë opinion të pakualifikuar, 11 të kualifikuar me shumë vërejtje dhe 3 mohim raporte kanë mohim të opinionit. Në fushatat lokale 3 raporte opinion të pakualifikuar, 8 opinion kanë opinion të kualifikuar, 5 raporte mohim të opinionit dhe se vërejtjet kryesore janë kryesisht të njëjta, veçse janë keqësuar. Ai shtoi se raportimet e koalicioneve kanë qenë problem këtë vit ku partitë politike nuk kanë respektuar që si koalicion të raportojnë dhe kanë ndodhur një mori keqkuptimesh. Pasi që ashtu kanë qenë në kontratë dhe ashtu janë financuar nga KQZ. Askush nuk ka qenë i kontraktuar që të auditorë koalicionin PAN në këtë rast, por PDK, AAK e Nisma. Në anën tjetër askush nuk ka qenë i kontraktuar të auditorë koalicionin as LDK-AKR-Alternativa, por as AKR-në dhe Alternativën si parti individuale dhe ne kemi kërkuar nga to që të bëjmë një raport të përbashkët.

Ali Lajçi falënderoi të pranishmit për prezencën. Tha se këto raporte tregojnë në mënyrë kaotike pasqyrat financiare dhe se duket se krejt këto janë një varg çështjesh që jo vetëm që ekzistojnë, por edhe na përcjellin në jetën tonë institucionale shtetërore. Ai tha se te partitë politike, dominon shumica e tyre që nuk japin raporte për shpenzime. Por një brengë, që z. Lajçi ceki është te KQZ pasi që tha se

as atje nuk qëndrojnë mirë pasi që duhet të jetë një institucion me legjitimitet të plotë dhe duhet të marrë vendime kredibile e që ato nuk po japin diçka të tillë. Gjithashtu shtoi se subjektet politike që janë me tradite më të gjatë, tregojnë neglizhencë në paraqitjen e obligimeve dhe marrjes së tyre në përgjegjësi dhe se shihet një trend i mirë në disa subjekte që kanë tentim të jenë korrekt dhe të japin raporte. Z. Lajçi u ankua edhe te Ligji për krijimin e grupeve të reja parlamentare. Shprehi pakënaqësi për mungesën e profesionalizmit të subjektet politike, për mungesën e kontabilistëve dhe në këtë mes këto tha se mbesin si çështje të hapura, e gjithashtu edhe mungesa e zbatimit të rekomandimeve.

Valon Ramadani u ndërlidh me z. Shatri kur gjatë bisedës çdo çështje që ngriti gjithmonë veçoi dy-tri parti për nga ana pozitive dhe se për shkak që po të flasim për të gjitha do merrte shumë kohë, e do ishte mirë që të flitet për ato dy-tri parti të cilat janë shembull ose se cilat janë ato dy-tri parti.

Driton Selmanaj tha se disa nga partitë politike kanë një degradim në krahasim me raportet për 3 vitet e kaluara, një prej tyre AAK, ka pas kualifikuar tash ka mohim të opinionit, PDS e KZA. do të dhëna me specifike, çka ka ndodhur me këto parti politike, cila është qasja e tyre, pse ka një degradim pse ka një regres?

Ymer Shatri tha se ka mbetur e pa audituar pjesa financiare që financon GP-te d.m.th. partitë politike nuk e përfshijnë në raportet e tyre financiare 10% e buxhetit që marrin, ato nuk i auditon as auditori gjeneral as kompanitë audituese private. Një këshillë dhe vërejtje për partitë politike, të cilat marrin para prej buxhetit dhe nuk paguajnë tatimet. Sa i përket dy partive janë Lista Serbe dhe SLS, janë dy parti të cilat kanë kontabilist të certifikuar dhe janë në gjendje të ofrojnë raportet në mënyrë efikase, SLS nuk ka qenë, siç duhet, por ka pranuar të bashkëpunojë dhe korrigjojnë sipas kërkesave tona, SLS mban edhe kontabilitetin sipas standardeve.

Sa i përket pyetjes së kryetarit ai tha se ato kanë degraduar pasi që nuk kanë pranuar të bashkëpunojnë, pasi që pas vërejtjeve nuk kanë ardhur të konsultohen. Mohimet janë në raste kur partitë politike nuk kanë dhënë dokumentacion mbështetës ose kanë refuzuar që të punojnë me ne.

Driton Selmanaj tha se AAK si vlerësim të shpenzime të fushatës 2017 ka prezantuar 252,000 euro nga to në vlerën prej 202,000 euro nuk ka pasur asnjë dokument mbështetës. A nuk kanë pasur dokument apo nuk dashur të i ofrojnë ato?

Ymer Shatri tha se arsyetimi kryesor ishte se raportet e koalicioni janë të dorëzuara si koalicion përmes PDK-së.

Valon Ramadani çfarë raporte ka publikuar Lista Serbe, çfarë fatura, nga kush financohet dhe cili është dallimi me subjektet tjera politike?

Ymer Shatri thotë një krahasim, Lista serbe nuk ka pasur shume shpenzime, të gjitha shpenzimet janë bërë me një llogari bankare, kanë sjellë fatura, kontrata, ishin në gjendje që veturën e furnizuar, zgjedhja e kompanisë që ju ka bërë hulumtimi, e kanë inspektuar ligjin e tenderimit, nga momenti që është regjistruar për neve ka qenë e gatshme të bashkëpunojë.

Albert Kinolli përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi z. Shatrin për punën. Ai tha se pasi që mos pagesa e tatimit ndaj shtetit është krim dhe se z. Shatri tha se partitë e vogla zakonisht i kanë ikur tatimit dhe z. Kinolli bën pjesë në një parti të vogël deshi të dinte se cilat janë ato parti të vogla të cilat i kanë ikur tatimit. Kinolli shtoi se për dallim nga subjektet politike të mëdha partia e tij nuk kanë shpenzime milionëshe dhe se dihet se për çdo 3 muaj në KQZ kryejnë raportimin të bashkëngjitura të gjitha dokumentet të cilat kërkohen.

Sabahate Hasanaj, tha se shqetësimi i parë te partia e z. Kinollit është problemi që prej

rekomandimeve të cilat janë dhënë nga rekomandimet paraprake nuk janë adresuar, shqetësimi i dytë tha se është e vërtetë që pagesa e tatimit është bërë, por se ka pasur fatura ne emrin e tij personal dhe është bërë pagesa prej llogarisë private, problemi tjetër tha se edhe tërheqja prej llogarisë së partisë është bërë pa asnjë dëshmi dhe për këtë arsye është mohuar opinioni për partinë e juaj.

Ali Lajçi, pyeti rreth shfrytëzimi i objekteve dhe pagesat e partive politike për shfrytëzimin e zyrave.

Ymer Shatri tha se kompanisë i intereson kontratat kush nuk i ka pas as qerese nuk ja kemi pranuar, kush nuk e ka ndalur tatimin në burim nuk ja kemi pranuar asnjë shpenzim sepse ka pasur shkelje të ligjit. Ligji thotë se qiramarrësi duhet ta paguajë dhe jo partia politike.

Driton Selmanaj falënderoi z. Shatrin për prezencën dhe përgëzoi për punën e mirë dhe objektive. Ne, si KMFP, kemi obligim ligjor dhe të japim rekomandime për KQZ dhe Partitë Politike. Ne do gjejmë mënyra se si t'i adresojmë rekomandimet dhe raportet e audituara për publikim në ueb faqe të KQZ-së.

Përfundim

KMFP vendosi që në mbledhjen e radhës së Komisionit të shqyrtohen rekomandimet e dala nga raporti i Auditimit të jashtëm për raportet financiare dhe atyre të deklarimit financiar të fushatës për subjektet politike për vitin 2017.

4. Të ndryshme.

Nuk pati diskutim në këtë pikë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj